

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 1 nga 18</i>

## **KODI I PUNËS PËR QASJE NË TOKË DHE NDËRTESA**

**Prishtinë**

**Shkurt 2018**

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 2 nga 18</i>

## PËRMBAJTJA

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>3</b>
<b>2</b>	<b>Përcaktimi i Termave dhe Definicionet.....</b>	<b>4</b>
<b>3</b>	<b>Kushtet e përgjithshme .....</b>	<b>8</b>
<b>4</b>	<b>Dispozitat e veçanta lidhur me punën në tokë .....</b>	<b>9</b>
4.2	Sëmundjet e shtazëve dhe bimëve.....	11
4.3	Pëlqimet dhe servitutet.....	12
4.3.2	Servitutet e zhvillimit të rrjetit.....	12
4.3.3	Rrjeti i ndërtuar para 10 qershorit 1999.....	13
4.3.4	Rrjeti i ndërtuar ndërmjet 10 qershor 1999 dhe 30 qershor 2006.....	14
<b>5</b>	<b>Qasja në lokacionet në pronësi ose të operuara nga përdoruesit e sistemit... 15</b>	
5.1.1	Kërkesat e qasjes 24 orë / 365 ditë.....	15
5.1.2	Qasja në pjesët tjera të instalimeve të përdoruesve të sistemit.....	16
<b>6</b>	<b>Përdorimi i gjuhëve .....</b>	<b>16</b>
<b>7</b>	<b>Procedura e kontesteve .....</b>	<b>17</b>
<b>8</b>	<b>Menaxhimi i kodit të punës për qasje në tokë dhe ndërtesa .....</b>	<b>17</b>
8.2	Rrethanat e paparashikuara.....	18
8.2.1	Ndërmarrja e veprimeve.....	18
8.2.2	Palët e prekura në pamundësi për të qenë në pajtueshmëri me këtë kod.....	18

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 3 nga 18</i>

## 1 Hyrje

- 1.1.1.1 **KOSTT**, gjatë procesit normal të aktiviteteve të afarizmit të vet, do të kërkoj që t'i qaset tokës ose ndërtesave që është në pronësi ose nën kontroll të palëve tjera. Të drejtat dhe obligimet e **KOSTT** lidhur me këtë normalisht janë përcaktuar në legjislacionin primar–Kapitulli VIII i **Ligjit për Energjinë** dhe legjislacionin sekondar – Neni 24 i **Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike**, Neni 5 i **Udhëzimit Administrativ Nr. 2005/7 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë**, të drejtës së **Servitutit**, ose në **Marrëveshjet e Kyçjes**.
- 1.1.1.2 Punëtorët e **KOSTT**-it dhe kontraktorët e **KOSTT**-it, kanë të drejtë të hyjnë në pronën private kur janë në detyrë të punës. **KOSTT** pranon se kjo e drejtë gjithashtu imponon obligime për të vepruar me kujdes të matur për të siguruar marrëdhënie të mira me pronarët e tokave dhe ndërtesave dhe duhet të ketë mirësjellje me **pronarët e tokave** (ose pronarët e ndërtesave) duke e njoftuar me kohë pronarin për qëllimin e hyrjes në tokë ose ndërtesa dhe duke u identifikuar para hyrjes në tokë ose ndërtesa private, përveç në rastet kur pronari nuk mund të identifikohet.
- 1.1.1.3 **Kodi i punës** përcakton mënyrën me të cilën punëtorët e **KOSTT** ose kontraktorët të cilët punojnë në llogari të **KOSTT** do t'i qasen tokës ose ndërtesës kur ata duhet të veprojnë në procesin normal të punës së **KOSTT**. Asnjë e drejtë nuk i kalon **KOSTT**-it ose ndonjë personi fizik ose juridik, por për përfitimin e të gjitha palëve të përfshira, përshkruan mënyrën me të cilën **KOSTT** zakonisht do të ushtron të drejtat e veta.
- 1.1.1.4 Në rrethana të jashtëzakonshme mund të mos jetë e mundur për **KOSTT** që të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e këtij kodi dhe është e nevojshme që me kohë të bëhen aranzhmane tjera. Sidoqoftë, pranimi nga **KOSTT** i aranzhmaneve alternative ose veprimet e njëanshme të ndërmarra nga **KOSTT** për të siguruar sigurinë e furnizimit nuk duhet të shikohet si ndryshim i këtij kodi por si interes i përgjithshëm që duhet të përkrahët nga të gjitha palët e përfshira sa më shumë që të jetë e mundur.

**KOSTT** si **Operator i Sistemit të Transmetimit**, është përgjegjës për administrimin e këtij Kodi të Punës që kushtëzohet paraprakisht me miratimin nga **Zyra e Rregullatorit për Energji**.

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 4 nga 19</i>

## 2 Përcaktimi i Termave dhe Definicionet

2.1.1.1 Në këtë kod të punës do të aplikohen definicionet vijuese:

Termi	Shkurtesa	Definicioni
Forca Madhore		Është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmblytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.
Prodhues		Person fizik ose juridik që prodhon energji elektrike.
Kodi i Pajisjeve Elektrike		Kodi i zhvilluar nga <b>KOSTT</b> dhe miratuar nga <b>ZRrE</b> që detajon pajisjet që mund të përdoren ose lidhen në <b>sistemin e transmisionit</b> të operuar nga <b>OST</b> .
Kodi i Punës për Qasje në Toka dhe/ose Ndërtesa		Ky kod, i zhvilluar nga <b>KOSTT</b> dhe i miratuar nga <b>ZRrE</b> i cili detajon aranzhmanet me të cilat <b>KOSTT</b> do të ketë qasje në tokë ose ndërtesa të cilat ende nuk janë në pronësi ose kontroll kur një gjë e tillë është e nevojshme për qëllime të ndërtimit, ndryshimit, operimit ose mirëmbajtjes së <b>Sistemit të Transmetimit</b> .
Kodi i Standardeve Elektrike		Kod i zhvilluar nga <b>KOSTT</b> dhe miratuar nga <b>ZRrE</b> i cili përcakton standardet e aplikueshme elektrike për <b>sistemin e transmetimit</b> të operuar nga <b>OST</b> .
Komisioni Qeverisës i Kodeve Teknike/Operacionale	KQKO	Komisioni i themeluar në përputhje me dispozitat e <b>procedurës së menaxhimit të kodeve teknike/operacionale</b> që mbikëqyr funksionimin e kodeve teknike dhe operacionale.
Kyçja		Interkonekcioni i dy <b>sistemeve</b> brenda Kosovës.
Licenca		Dokumenti i lëshuar nga <b>Zyra e Rregullatorit për Energji</b> që i mundëson bartësit të licencës të ushtrojë aktivitete në sektorin e energjisë për të cilat nevojitet <b>Licenca</b> në përputhje me dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë.
Ligji për Energjinë		Është ligji Nr. 05/L-081 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

**KODI I PUNËS****PO-KO-011**

ver. 1.2

faqe 5 nga 19

<b>Termi</b>	<b>Shkurtesa</b>	<b>Definicioni</b>
Ligji për Energjinë Elektrike		Është ligji Nr. 05/L-085 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
Ligji për Kadastër		Është ligji me Nr. 04/L-013 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
Ligji për Përdorimin e Gjuhëve		Është ligji me Nr. 02/L-37 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe i shpallur me rregulloren e UNMIK/REG/2006/51.
Ligji për Planifikimin Hapësinor		Është ligji me Nr. 04/L-174 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
Ligji për Rregullatorin e Energjisë		Është ligji Nr. 05/L-084 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtëshme		Është ligji me Nr. 03/L-205 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
Marrëveshja e Kycjes		Një marrëveshje dypalëshe ndërmjet <b>OST</b> dhe një <b>shfrytëzuesi të sistemit</b> që detajon kushtet për kyçje në <b>sistemin e transmetimit</b> .
Ministria		Përveç ku thuhet ndryshe, është ministria përgjegjëse për energji.
Ngastra Ndërtimore		Ka të njëjtin kuptim si në <b>Ligjin për planifikimin hapësinor</b> .
Operatori i Sistemit të Transmisionit	<b>OST</b>	Person fizik ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar përfshirë kurdo që kjo është e mundur, interkonektorët me sistemet tjera, dhe për të garantuar aftësinë afatgjatë të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike.
Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut	<b>KOSTT</b>	Është Operator i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës i cili është përgjegjës për planifikimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë sigurimin e qasjes së hapur dhe jo diskriminuese dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike.
Pala		Është pala që ka një pikë të kyçjes të përbashkët me sistemin e transmetimit.
Shfrytëzuesit e Sistemit		Personat fizik dhe juridik që e furnizojnë ose furnizohen nga një sistem i transmetimit ose shpërndarjes

<b>Termi</b>	<b>Shkurtesa</b>	<b>Definicioni</b>
Pikë e Kyçjes		Pika e dakorduar për <b>furnizimin</b> e vendosur ndërmjet <b>OSTT</b> dhe një shfrytëzuesi të sistemit.
Plani Hapësinor për Kosovë		Është dokument i planifikimit hapësinor i nivelit qendror, në pajtim me dispozitat e <b>Ligjit për planifikimin hapësinor</b> .
Plani Hapësinor për Zona të Veçanta		Është dokumenti i planifikimit hapësinor i nivelit qendror që vendos një organizim të posaçëm të zhvillimit, përdorimit dhe regjimit mbrojtës për zonat e veçanta të përcaktuara në Hartën zonale të Kosovës, në pajtim me dispozitat e <b>Ligjit për planifikimin hapësinor</b> .
Plani Rregullues Urban		Është plani me atë emër i zhvilluar në pajtim me <b>ligjin për planifikimin hapësinor</b> .
Plani Zhvillimor Urbanistik		Është plani me atë emër i zhvilluar në pajtim me <b>ligjin për planifikimin hapësinor</b> .
Plani Zhvillimor Komunal		Është dokument i planifikimit hapësinor i nivelit lokal, në pajtim me dispozitat e <b>Ligjit për planifikimin hapësinor</b> .
Procedura e Menaxhimit të Kodeve Teknike/Operacionale		Procedurat e qeverisjes së kodeve teknike/operacionale të nxjerra nga <b>Rregullatori</b> , në pajtim me <b>Ligjin për Rregullatorin e Energjisë</b>
Pronari i tokës		Person fizik ose përfaqësues i personit juridik i shënuar në <b>Regjistrin Kadastral</b> relevant si pronar i ngastrës së caktuar kadastrale.
Regjistri Kadastral		Regjistri në të cilin janë shënuar të drejtat për pronën e paluajtshme. Agjensioni Kadastral i Kosovës ka autoritet për administrimin e përgjithshëm të Regjistrit, në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit të aplikueshëm.
Rregulla për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë në Kosovë		Rregulla të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, që paraqesin bazën për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë.
Servituti		E drejtë ligjore e një pale që të ketë qasje mbi ose nën sipërfaqe të tokës e cila i takon <b>pronarit të tokës</b> . Për të siguruar se cilido pronar i ardhshëm i pronës është i vetëdijshëm për ekzistimin e servitutit, ai do të regjistrohet në <b>regjistrin përkatës kadastral</b> .

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>fajqe 7 nga 19</i>

<b>Termi</b>	<b>Shkurtesa</b>	<b>Definicioni</b>
Sistemi i Transmetimit	ST	Sistemi i përbërë nga kombinimi i linjave, nënstacioneve dhe stabilimenteve të tensionit të lartë që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike.
Transmetimi		Transportimi i energjisë elektrike, përmes sistemeve të tensionit të lartë dhe sistemeve të interkonektuara të tensionit të lartë, me qëllim të dërgimit deri te konsumatorët fundorë apo te operatorët e sistemit të shpërndarjes, por pa përfshirë furnizimin;
Udhëzimi Administrativ mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë		Është udhëzimi administrativ numër 2005/7 i miratuar nga Qeveria e Kosovës sipas <b>Ligjit për Energji</b> .
Zyra e Rregullatorit për Energji	ZRrE	Është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

2.1.1.2 Përveç kuptimeve të veçanta që janë në Përcaktimin e Termave dhe Definicione më lartë, brenda këtij dokumenti disa fjalë dhe fraza kanë kuptimet vijuese:

- Referencat në gjininë mashkullore duhet të përfshijnë edhe gjininë femërore dhe referencat në njëjës duhet të përfshijnë edhe referencat në shumës dhe anasjelltas,
- Aty ku ky kod i punës specifikon informatat me shkrim ose konfirmimin me shkrim që duhet të jepen, cilido mjet i transferit elektronik i cili mundëson që pranuesi të marr informatën – si posta elektronike ose FAKSI e përmbushin këtë kërkesë,
- Përveç rasteve ku shprehimisht thuhet ndryshe të gjitha referencat në seksione do të jenë referenca në seksione në këtë kod,
- Cilado referencë në një ligji ose rregullore do të jetë referenca në atë ligj ose rregullore të aplikueshme në Kosovë, ose pas zëvendësimit të atij ligji ose rregullore me një ligj ose rregullore të re nga data e hyrjes në fuqi.

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 8 nga 19</i>

### 3 Kushtet e përgjithshme

3.1.1.1 Kushtet e përgjithshme të cilat **KOSTT** do të aplikoj në qasjen në tokë dhe ndërtesa nga punëtorët ose kontraktorët në emër të **KOSTT** janë:

- a) Punëtorët dhe kontraktorët që veprojnë në emër të **KOSTT** do të njoftohen për përgjegjësitë e tyre para hyrjes në tokë ose ndërtesa private ose para përballjes me **pronarët e tokave** ose shfrytëzuesve të tokës ose ndërtesës.
- b) Punëtorët ose kontraktorët që operojnë në emër të **KOSTT** duhet të posedojnë aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e kërkuara nga **KOSTT** dhe duhet të jenë njoftuar me këtë Kod të Punës lidhur me qasjen në tokat dhe ndërtesat e palëve të treta.
- c) Punëtorët ose kontraktorët që operojnë në emër të **KOSTT** do të hyjnë në tokë ose ndërtesa private vetëm për qëllime legjitime të ndërlidhura me aktivitetet e licencuara të **KOSTT**, përfshirë inspektimin e pajisjeve, mirëmbajtjen dhe ndërtimin.
- d) Përfaqësuesit e **KOSTT** do të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të kontaktuar pronarin e tokës ose ndërtesës për ta njoftuar me qëllimin e hyrjes në tokën private ose ndërtesa. Punëtorët do të bartin kartelat e identifikimit dhe kontraktorëve do t'u jepet një letër njoftim me shenjë të **KOSTT** dhe këto dokumente do t'i prezantohen pronarit të tokës ose ndërtesës kur ata prezantohen. Kartelat e identifikimit dhe letrat e prezantimit do të përmbajnë një numër të telefonit i cili mund të kontaktohet për të verifikuar autencitetin e dokumenteve.
- e) Për të ndihmuar identifikimin e përfaqësuesve të **KOSTT**, të gjitha automjetet e operuara nga kompania të cilat rregullisht vizitojnë vend punishtet do të kenë logon e **KOSTT**. **KOSTT** do të ketë minimum një logo në secilën anë të automjetit e cila do të jetë e madhësisë së mjaftueshme të jetë e dukshme prej një distance minimale prej 100m. Uniformat e punës të **KOSTT** do të kenë logon e **KOSTT**. Të gjithë punëtorët të cilët kanë uniforma janë të obliguar t'i bartin ato. Kontraktorët të cilët operojnë në emër të **KOSTT** do të jenë të detyruar që të tregojnë logon e kompanisë.
- f) Pronarët e tokës do të trajtohen drejtë dhe me sinjeritet.
- g) Pyetjet e pronarëve të tokës ose ndërtesave do të trajtohen me shpejtësi dhe me mirësjellje. Në rast të pyetjeve nga pronarët e tokës ose ndërtesave për informata plotësuese në kohën e vizitës, një numër kontaktues për **KOSTT** duhet të ofrohet.
- h) Punëtorët dhe kontraktorët të cilët punojnë në emër të **KOSTT** do të jenë të vëmendshëm dhe kujdesshëm për të minimizuar dëmtimin e tokës nga personat ose pajisjet. Kurdoherë që është e mundur do të parandalohet ndotja dhe lirimi i



	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 9 nga 19</i>

materialeve të rrezikshme dhe vajit. Në rast se ka ndonjë incident të ndotjes do të ndërmerren masa për të minimizuar ndikimin në ambient dhe në shëndetin e njerëzve ose shtazëve.

- i) Do të ndërmerret kujdes dhe vëmendje e veçantë për të minimizuar rrezikun e përhapjes së çfarëdo sëmundje të shtazëve dhe bimëve në tokën bujqësore.
- j) Punëtorët dhe kontraktorët që operojnë në emër të **KOSTT** do të ndërmarrin hapat e arsyeshëm për të siguruar që toka dhe ndërtesa mbeten në gjendje të mirë si në momentin kur ata kanë arritur.
- k) Duke marrë parasysh kërkesat për sigurinë publike, punëtorët dhe kontraktorët që punojnë për **KOSTT** do të përpiqen për të siguruar që kufizimet për përdorimin e tokës dhe ndërtesave gjatë punëve ndërtimore ose testimi të pajisjeve të minimizohen.

#### 4 Dispozitat e veçanta lidhur me punën në tokë

- 4.1.1.1 **KOSTT** do jep njoftim sipas afateve të parapara me ligj për zhvillimin e aktiviteteve të ndërtimit ose punëve të mirëmbajtjes, por do të ketë raste kur njoftimi nuk do të mund të jepet paraprakisht. Në këto raste **KOSTT** do të kontaktoj **pronarin e tokës** sa më parë që të jetë e mundur.
- 4.1.1.2 Në ndërmarrjen e punëve të ndërtimit dhe mirëmbajtjes në tokë, punëtorët dhe kontraktorët do të kenë kujdes që t'i mbyllin të gjitha portat kur largohen dhe mos të shkaktojnë dëmtim të rrethojave. Çfarëdo dëmtimi që nuk evitohet vetvetiu i rrethojave do të rregullohet nga **KOSTT** brenda një muaji dhe çdo dëmtim i rrethojave i cili kërkon vëmendje urgjente do të rregullohet ose përmirësohet brenda dy javëve nga njoftimi.
- 4.1.1.3 Gropat testuese para planit të ndërtimit kryesor, aty ku është e nevojshme, do të hapen vetëm pas konsultimit me **pronarin e tokës**. Mënyra e kryerjes së kësaj pune do të jetë e tillë ashtu që të shkaktohen sa më pak çrregullime. Gropat testuese duhet të hapen dhe mbyllin në të njëjtën ditë ose të sigurohen me rrethoja. Dheu i sipërm do të palohet anash, ndaras për rivendosje kur të rimbushet gropa. Dheu i poshtëm do të ngjeshët mirë dhe dheu sipërfaqësor do të shtrihet mbi të. Shkëmbinjtë dhe mbeturinat tjera të nxjerra gjatë gropimit do të largohen nga lokacioni nga ana e **KOSTT**. Gurët e nxjerrë gjatë gropimit do të largohen nga sipërfaqja.

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 10 nga 19</i>

- 4.1.1.4 Para fillimit të punëve ndërtimore një përfaqësues i **KOSTT** do të diskutoj rrugët e qasjes për ndërtim dhe për aq sa është e mundur do t'i jap **pronarit të tokës** programin e propozuar të punës dhe datën e fillimit të punës. Përfaqësuesi i **KOSTT** do jep pronarit të tokës ose ndërtesës emrin dhe adresën e personit që duhet të kontaktohet në rast të pyetjeve për aktivitetet e **KOSTT** në tokë ose ndërtesa. Aty ku punët ndërtimore duhet të kryhen dhe janë pajtuar rrugët e qasjes, atëherë në rast se për punë nevojitet më shumë se një pikë e hyrjes, rrugët e pajtuara do të shënjohen me shenja të vendosura në intervale të përshtatshme nëse **pronari i tokës** kërkon ashtu.
- 4.1.1.5 Përveç nëse pajtohet ndryshe me **pronarin e tokës**, punëtorët ose kontraktorët e **KOSTT** do ti prejnë drunjte që mund të prehen në gjatësi të transportueshme dhe të palohen mirë afër në tokën e pa përdorur për tu marr nga **pronari i tokës**. **KOSTT** do të largoj të gjitha mbeturinat nga prerja e drunjëve të shkaktuar nga aktivitetet e tij gjatë ndërtimit dhe mirëmbajtjes së linjave. Përveç rasteve urgjente që ndikojnë ose sipas pikëpamjes së arsyeshme të **KOSTT** që është e mundur të ndikojë në sigurinë e **Sistemit të Transmetimit, pronari i tokës** ose përfaqësuesi i tij do të njoftohet paraprakisht për hyrjen nga përfaqësuesit e **KOSTT** për qëllim të krasitjes së rrethojave dhe prerjes së drunjëve në lidhje me ndërtimin dhe mirëmbajtjen.
- 4.1.1.6 Aty ku është e nevojshme, me qëllim të mbrojtjes së personave, shtazëve dhe të mbjellave si dhe parandalimin pa leje, **KOSTT** do të ndërton pengesa – bariera për mbrojtjen e kategorive të cekura më lartë. Në përcaktimin e tipit të rrethojave dhe pengesave që do të ngriten do të konsiderohet lokacioni, qëllimi dhe qëndrimi i pritur në lokacionin përkatës. Nëse është e nevojshme për të rrethuar një zonë e cila kalon shtigjet, rrugët ose rrugët ekzistuese të qasjes së kërkuar nga **pronari i tokës**, **KOSTT** do të ofroj mjete për kalimin e tyre sipas kërkesave të arsyeshme të **pronarit të tokës**, kalimi i personave, makinerisë dhe bagëtisë sipas nevojës gjatë kohëzgjatjes së punëve.
- 4.1.1.7 Të gjitha shtigjet dhe rrugët permanente të ndikuara nga ndërtimi do të rikthehen nga **KOSTT** në gjendjen e njëjtë sikur para fillimit të ndërtimit ose aranzhmaneve alternative të pajtuara.
- 4.1.1.8 Para fillimit të punëve ndërtimore ose shpimeve testuese, **pronari i tokës** do të njoftoj **KOSTT** për tipin dhe madhësinë e të gjitha shërbimeve nëntokësore, gypave, drenazheve, puseve për aq sa **pronari i tokës** është në dijeni.

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 11 nga 19</i>

- 4.1.1.9 Para fillimit të punëve ndërtimore ose shpimeve testuese në zonat e populluara, **KOSTT** gjithashtu do të kontaktoj të gjithë personat relevant dhe kompanitë – përfshirë edhe **pronarin e tokës** gjithashtu dhe kompanitë e shërbimeve publike – për të marr të gjitha informatat në dispozicion për tipin dhe pozitën e të gjitha shërbimeve nëntokësore, gypave, linjave telefonike, etj.
- 4.1.1.10 Të gjitha rrjedhat e ujërave dhe furnizimet e ujit do të mbrohen nga ndotja e mundshme gjatë kryerjes së punëve. Do të merren të gjithë hapat e duhur për të mënjanuar ndërhyrjen me furnizimet e ujit të përdorur nga popullata ose shtazët e tyre.
- 4.1.1.11 Aty ku puna ndërtimore ndërlidhet me drenazhin, rezervoarët septik ose sistemet e ujitjes, **KOSTT** do t'i mbaj këto operime me ndërhyrje minimale gjatë vazhdimit të punës dhe **pronari i tokës** do të ofroj të gjitha lehtësirat për të mundësuar **KOSTT** të veproj. Këto shërbime rrjedhimisht do të rivendosen për kënaqësinë e arsyeshme të **pronarit të tokës** ose organizatës përgjegjëse për operimin e sistemeve të ujitjes sipas nevojës ose shërbimin alternativ ekuivalent të ofruar.
- 4.1.1.12 Të gjitha kanalet, drenazhet e hapura ose rrjedhat e ujit të ndërlidhura nga punët do të mirëmbahen në gjendje efektive gjatë ndërtimit dhe do të rikthehen në gjendje të ngjashme sikur para fillimit të punëve.
- 4.1.1.13 Në përfundimin e punëve, **KOSTT** do të largoj të gjitha ndërtesat e përkohshme, rrugët dhe tepricën e dheut, gurëve ose zhavorrit dhe çfarëdo materiali që natyrshëm nuk i përket lokacionit dhe është sjellë aty si rezultat i operimeve të **KOSTT**.

## **4.2 Sëmundjet e shtazëve dhe bimëve**

- 4.2.1.1 **KOSTT** do të respektoj të gjitha rregulloret të cilat mund të jenë në fuqi në lidhje me cilëndo skemë për zhdukjen e sëmundjeve të shtazëve ose bimëve e themeluar nga ministria relevante përfshirë regjistrimin dhe dezinfektimin e automjeteve që hyjnë në ferma nëse është e nevojshme.
- 4.2.1.2 Kur është e mundur, **KOSTT** do të siguroj që automjetet dhe makineritë mos të lëvizin nëpërmjet oborrit të fermave ose vendeve tjera ku ka akumulim të plehrave të shtazëve.

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 12 nga 19</i>

### 4.3 Pëlqimet dhe servitutet

4.3.1.1 Në planifikimin e zhvillimit të rrjetit të vet, **KOSTT** ka parasysh **planin hapësinor** për Kosovë, **planet hapësinore për zonat e veçanta** dhe të gjitha **planet zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbanistike dhe planet rregulluese urbane**. Në themelimin ose modifikimin e këtyre planeve, **KOSTT** pret që t'i jepet konsideratë e duhur lokacioneve të infrastrukturës së rrjetit.

4.3.1.2 **KOSTT** njeh obligimin e vet që në bazë të të gjitha planeve të cekura më lartë do të siguroj lejet përkatëse e sidomos për mbrojtje të ambientit dhe për pëlqimin mjedisor nga MMPH sipas raportit paraprak për Vlerësim të Ndikimit Mjedisor

#### 4.3.2 Servitutet e zhvillimit të rrjetit

4.3.2.1 Para ndërtimit të zhvillimeve të reja të rrjetit, **KOSTT** do të ketë të drejtën e **servitutit** në pronat private për të gjithë largpërçuesit dhe të gjitha kabllot në të gjitha nivelet e tensionit që kalojnë në tokën tjetër pas zhvillimit të procedurave sipas legjislacionit në fuqi. Të gjitha përfundimet e qarqeve dhe stabilimentet në tokën e cila nuk është në pronësi apo kontroll të **KOSTT** do të shënohen vetëm në **marrëveshjen e kyçjes**. **KOSTT** do të siguroj që pronësia e pozitave të shtyllave dhe e drejta e **servituteve** për largpërçuesit dhe kabllot nëntokësore të regjistrohen në **regjistrin kadastral** ashtu që autoriteti relevant komunal mund të aranzhoj që zonat e përshtatshme të sigurisë të identifikohen në **planet hapësinore për zonat e veçanta, planet zhvillimore komunale, planet zhvillimore urbanistike dhe planet rregulluese urbane**.

4.3.2.2 E drejta e **shpronësimit** dhe **servitutit** zhvillohet në bazë të një vendimi të lëshuar nga organi qendror përkatës (Qeveria e Kosovës apo Organet Komunale) dhe pas zhvillimit të procedurave sipas legjislacionit në fuqi. Pas këtyre zhvillimeve prona e shpronësuar dhe **servituti** do të regjistrohen në regjistrat kadastral të komunës përkatëse.

a) **Pronari i tokës** për të cilën do të vendoset e drejta e **shpronësimit** dhe /ose **servitutit** do të kompensohet bazuar në procedurat dhe vlerësimin sipas **Ligjit** në fuqi **për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme**, pa qenë e nevojshme të bëhen pagesa tjera gjatë çfarëdo periudhe, pajisja ose zëvendësimi i pajisjes mbetet në pozitën e njëjtë ose esencialisht të njëjtë.

Pas aprovimit të shpronësimit dhe të drejtës së **servitutit**, bëhet vlerësimi i lartësisë së kompensimit për dëmet që mund të shkaktohen gjatë punimeve nga punëtorët dhe kontraktorët e **KOSTT**. Në rastet e implementimit të projektit të ri për

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 13 nga 19</i>

ndërtimin e linjave, kompensimi i dëmit bëhet nga ana e KOSTT-it nëse nuk është ndryshe e potencuar në kontratën me kontraktorin. Ndërsa në rastet e mirëmbajtjes së linjave vlerësimi bëhet në bazë të një ekspertize të kulturës së dëmtuar në marrëveshjen e arritur në mes palës së dëmtuar dhe komisionit përkatës.

- b) **Pronari i tokës** do të jetë i obliguar që të menaxhoj veprimet e veta për të parandaluar dëmtimin e pajisjeve që përbëjnë pjesë të rrjetit;
- c) **Pronari i tokës** do të jetë i obliguar të kompensoj **KOSTT** për shpenzimet e arsyeshme të **KOSTT** ku **pronari i tokës** shkelë zonën e sigurisë ose shkakton që zona e sigurisë të shkelet;
- d) **KOSTT** të ketë të drejtë të qasjes së lirë në asetet që përbëjnë pjesë të rrjetit të vetë;
- e) **KOSTT** të ketë të drejtë të ndërmarr pastrimin e drunjve dhe shkurreve në afërsi të largëpërçuesve për aq sa është e nevojshme për sigurinë e **sistemit të transmetimit**. Në këtë rast **pronari i tokës** nuk do të ketë të drejtë në kompensim për humbjen e drunjve, por **KOSTT** do të jetë përgjegjës që të sigurohet që të mos shkaktohen dëme tjera në pronën e **pronarit të tokës**.

4.3.2.3 Në rastin ku puna për ripërtirjen e rrjetit, ku strukturat ose kabllot janë duke u ndërruar në pozitën përafërsisht të njëjtë, e drejta e **servituteve** normalisht do të mbetet e njëjta sepse supozohet se ato janë marrë në kohën e ndërtimit të parë. Në rastin e strukturës së re ose kabllit të ri dhe kur vendosen në lokacione të reja, atëherë këto struktura të reja do të jenë të kushtëzuara me një ndryshim të së drejtës së servitutit.

4.3.2.4 Autoritetet komunale nuk do të pyeten për një **servitut** kur **KOSTT** ka për qëllim të shtrij kabllot në shtigjet ose rrugët publike. **KOSTT** do të konsultoj autoritetet komunale para kryerjes së punës dhe do të respektoj cilat do kushte të arsyeshme specifike të cilat autoritetet komunale kanë të drejtë t'i imponojnë p.sh. kërkesat e trafikut për të kufizuar punën në orët e caktuara, dinamikën e kryerjes së punëve.

4.3.2.5 Marrëveshjet formale gjithmonë do të lidhen nga zyrtarët e autorizuar të **KOSTT**. **KOSTT** do të ndërmarrë negociatat fillestare me **pronarët e tokës** për të lejuar pozitën e shtyllave ose kabllave të përcaktuara si pjesë e procesit të para ndërtimit.

### 4.3.3 Rrjeti i ndërtuar para 10 qershorit 1999

4.3.3.1 Një pjesë e rrjetit e operuar nga **KOSTT** është ndërtuar para 10 qershor 1999. Legjislacioni aktual përcjell të njëjtat principe të cilat janë përcjellë për shume vite dhe

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 14 nga 19</i>

**KOSTT** nënkupton që këto pjesë të rrjetit janë ndërtuar në pajtueshmëri me marrëveshjet e lidhura me **pronarët e tokës** dhe se nën kushtet e rregullores së UNMIK/REG/2000/59 për ligjin e aplikueshëm në Kosovë, këto marrëveshje vazhdojnë të kenë efekte ligjore.

4.3.3.2 **KOSTT** nuk ka qasje në këto marrëveshje por nënkupton se të gjitha marrëveshjet për këto pjesë të rrjetit kanë qenë në bazë të:

- a) Një pagese të vetme për **pronarin e tokës** në kohën kur ndërtimi përfundon në tokën e tyre, pa qenë të nevojshme pagesa tjera gjatë çfarëdo periudhe pajisja ose zëvendësimi i pajisjes mbetet në pozitën e njëjtë ose esencialisht e njëjtë;
- b) Që **pronari i tokës** të jetë i obliguar që të menaxhoj operimet e veta për të parandaluar dëmtimin e pajisjeve që përbëjnë pjesë të rrjetit;
- c) Që **pronari i tokës** të jetë i obliguar të kompensoj **KOSTT**-in për shpenzimet e arsyeshme të **KOSTT**-it ku **pronari i tokës** shkelë zonën e sigurisë ose shkakton që zona e sigurisë të shkelet;
- d) **Operatori i Sistemit të Transmetimit** gjegjësisht **KOSTT** – të ketë të drejtë të qasjes së lirë në asetet që përbëjnë pjesë të rrjetit të vetë;
- e) **Operatori i Sistemit të Transmetimit** gjegjësisht **KOSTT** – të ketë të drejtë të ndërmarr pastrimin e drunjve dhe shkurreve në afërsi të largëpërçuesve për aq sa është e nevojshme për të siguruar sigurinë e **sistemit të transmetimit**. Në këtë rast **pronari i tokës** nuk do të ketë të drejtë në kompensim për humbjen e drunjve, por **KOSTT** do të jetë përgjegjës që të siguroj që të mos shkaktohen dëme tjera në pronën e **pronarit të tokës**.

4.3.3.3 **KOSTT** do të ndërmerr operimet e tij në përputhje me obligimet që i vendosen me ligj dhe me këtë kod të punës. Aty ku është e nevojshme **KOSTT** do të zëvendësoj asetet ekzistuese me asetet ekuivalente dhe të mbështetet në marrëveshjen origjinale, edhe atëherë kur ajo nuk mund të gjendet.

4.3.3.4 Në rastin kur kërkohet ashtu nga **pronari i tokës**, **KOSTT** do të hyj në një marrëveshje me **pronarin e tokës** e cila formalizon dhe vazhdon marrëveshjen paraprake në kushtet e theksuara në paragrafin 4.3.3.2. Pasi që **KOSTT** beson se pagesa e duhur tashmë është kryer, ky aranzhman nuk do të rezultojë në pagesë tjetër për **pronarin e tokës**.

#### 4.3.4 Rrjeti i ndërtuar ndërmjet 10 qershor 1999 dhe 30 qershor 2006

4.3.4.1 Një pjesë e rrjetit të operuar nga **KOSTT** është ndërtuar pas 1999 por para ekzistimit të **KOSTT**. **KOSTT** nuk është i sigurtë nëse të gjitha këto pjesë të rrjetit, të

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 15 nga 19</i>

ndërtuara për interesin publik, janë ndërtuar nën marrëveshje me **pronarët e tokës** por supozon që praktika paraprake është vazhduar me lidhjen e marrëveshjeve me **pronarët e tokave** në bazë të:

- a) Një pagese të vetme për **pronarin e tokës** në kohën kur ndërtimi përfundon në tokën e tyre, pa qenë të nevojshme pagesa tjera gjatë çfarëdo periudhe pajisja ose zëvendësimi i pajisjes mbetet në pozitën e njëjtë ose esencialisht të njëjtë
- b) Që **pronari i tokës** të jetë i obliguar që të menaxhoj operimet e veta për të parandaluar dëmtimin e pajisjeve që përbëjnë pjesë të rrjetit;
- c) Që **pronari i tokës** të jetë i obliguar të kompensoj **KOSTT** për shpenzimet e arsyeshme të operatorit ku **pronari i tokës** shkelë zonën e sigurisë ose shkakton që zona e sigurisë të shkelet.
- d) **Operatori i Sistemit të Transmetimit** gjegjësisht **KOSTT** – të ketë të drejtë të qasjes së lirë në asetet që përbëjnë pjesë të rrjetit të vetë;
- e) **Operatori i Sistemit të Transmetimit** gjegjësisht **KOSTT** – të ketë të drejtë të ndërmarr pastrimin e drunjve dhe shkurreve në afërsi të largëpërçuesve për hapësirat ashtu siç është definuar në dispozitat e rregullores për krijimin e servitutit apo për aq sa është e nevojshme për të garantuar sigurinë e **sistemit të transmetimit**. Në këtë rast **pronari i tokës** nuk do të ketë të drejtë në kompensim për humbjen e drunjve, por **KOSTT** do të jetë përgjegjës që të siguroj që të mos shkaktohen dëme tjera në pronën e **pronarit të tokës**.

4.3.4.2 **KOSTT** do të ndërmarr operimet e veta në pajtueshmëri me obligimet ligjore dhe me këtë kod të punës. Aty ku është e nevojshme, **KOSTT** do të zëvendësoj asetet ekzistuese me asetet ekuivalente dhe të mbështetet në marrëveshjen origjinale, edhe atëherë kur ajo nuk mund të gjendet.

## 5 Qasja nga shfytëzuesit e sistemit

### 5.1.1 Kërkesat e qasjes 24 orë / 365 ditë

5.1.1.1 Për të garantuar operimin e sigurtë të rrjetit publik të energjisë elektrike, **KOSTT** mundëson qasje për **shfrytëzuesit e sistemit** në të gjitha pajisjet e tyre sa herë që kjo është e nevojshme. Kjo mund të përfshijë pjesët e **shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit** të cilat ndodhen brenda lokacioneve në pronësi ose të operuara nga **KOSTT** – veçanërisht në **pikat e kyçjes** ndërmjet rrjeteve.

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 16 nga 19</i>

5.1.1.2 **KOSTT** duhet të bëjë aranzhmane që përfaqësuesit e **shfrytëzuesit të sistemit** të kenë qasje sa herë që është e nevojshme në pajisjet dhe stabilimentet që i takojnë **shfrytëzuesit të sistemit** ku operimi i tyre është i nevojshëm për të siguruar izolimin e pjesëve të **Sistemit të Transmetimit** nga mundësia e furnizimit kthyes ose të furnizimeve nga gjenerimi dhe pajisjeve të matjes përfshirë kabllimin dhe transformatorët matës.

5.1.1.3 **KOSTT** pranon se në rast të instalimeve të reja të ndërtuara siç përcaktohet në **kodin e pajisjeve elektrike**, kjo mund të arrihet duke ofruar qasje në një fushë të stabilimenteve dhe hapësirës së dhomës komanduese e cila është e ndarë fizikisht nga hapësirat të cilat i përdor **shfrytëzuesi i sistemit** ose në të cilat ai ka qasje, **KOSTT** duhet që sa herë që është e nevojshme të ofroj qasje **shfrytëzuesit të sistemit** në pajisjet e specifikuar në seksionin 5.1.1.1 dhe 5.1.1.2. Përveç nëse përcaktohen aranzhmane alternative në **marrëveshjen e kyçjes**, qasja do t'i ofrohet **shfrytëzuesit të sistemit** përmes rrugëve në të cilat mund të qasen duke përdorur një çelës nga pakoja standarde e çelësave të **KOSTT**. Aty ku **shfrytëzuesi i sistemit** gjithashtu ka të drejtë qasje në këto hapësira, **shfrytëzuesi i sistemit** do të përshtat mbylljen e dyfishtë të tillë që cilado **palë** mund të ketë qasje të pavarur.

## 5.1.2 Qasja në pjesët tjera të instalimeve të shfrytëzuesëve të sistemit

5.1.2.1 **KOSTT** mund të kërkoj qasje në të gjitha pajisjet e operuara nga **shfrytëzuesi i sistemit** në kohë të arsyeshme, por nuk kufizohet në situatat kur **KOSTT** është duke hetuar shkakun e devijimeve nga **kodi i standardeve elektrike**. Kurdoherë që është e mundur **KOSTT** do të bëjë kontakte paraprake me **shfrytëzuesin e sistemit** dhe të aranzhoj që qasja të sigurohet kur është e nevojshme. Kur **KOSTT** është duke hetuar një problem të **Sistemit të Transmetimit** i cili arsyeshëm duket të jetë shkaktuar nga operimi i **shfrytëzuesit të sistemit** dhe qasja e plotë nuk është e mundur, **KOSTT** mundet të shkyç instalimin e **shfrytëzuesit të sistemit** nga **rrjeti i transmetimit** derisa të mundësohet qasja.

## 6 Përdorimi i gjuhëve

6.1.1.1 **KOSTT** do të lidhë marrëveshjet me shkrim të formatit standard në cilëndo gjuhë e cila e ka statusin e gjuhës zyrtare komunale në cilëndo pjesë të Kosovës siç definohet



	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 17 nga 19</i>

në **Ligjin për përdorimin e gjuhëve**. Në mungesë të zgjedhjes nga **pala** tjetër, **KOSTT** do të propozoj gjuhën që do të përdoret.

- 6.1.1.2 Kartela e identifikimit dhe letra e prezantimit e referuar në paragrafin 3.1.1.1 rrjedhimisht do të përdor gjuhët zyrtare të Kosovës si definohet në **Ligjin për përdorimin e gjuhëve**.
- 6.1.1.3 Çfarëdo dokumenti tjetër i përgatitur për të përmbushur kërkesat e këtij kodi do të përgatitet në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës si definohet në **Ligjin për përdorimin e gjuhëve**. Zgjedhja mund të bëhet nga **pala** tjetër por kur një zgjedhje e tillë nuk bëhet **KOSTT** do të jetë i lirë të zgjedhë gjuhën që do të përdoret.
- 6.1.1.4 **KOSTT** nuk mund të garantoj që përfaqësuesit e tij të cilët kërkojnë qasje në rrjetin e operuar nga **KOSTT** do të jenë në gjendje të flasin në gjuhën e caktuar. **KOSTT** do të ndërmer hapat e arsyeshëm për të siguruar që arsyeja për vizitën mund të shpjegohet në gjuhët zyrtare të Kosovës (siç definohet në **Ligjin për përdorimin e gjuhëve**) qoftë gojarisht, duke ju referuar kartelave të identifikimit ose duke ofruar një numër telefoni i cili mund të thirret për ndihmë. Vështërsitë në komunikim nuk do të trajtohen nga **KOSTT** si arsye për të penguar përfaqësuesit e tij në kryerjen legjitime të detyrave të tyre.

## 7 Procedura e kontesteve

- 7.1.1.1 Mosmarrëveshjet për pozitën e propozuar të shtyllave ose nivelin e kompensimit do të zgjidhen sipas aranzhmaneve të themeluara për të lejuar zhvillimin e rrjetit në pajtim me Kapitullin VIII të **Ligjit për Energjinë**. Kontestet që dalin nga operimi i këtij kodi do të trajtohen në pajtim me **rregullën për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë në Kosovë** të miratuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji** si mjet për zgjidhjen e kontesteve që dalin nga palët në tregun e energjisë.

## 8 Menaxhimi i Kodit të Punës për Qasje në Tokë dhe ndërtesa

- 8.1.1.1 Revidimet e këtij kodi do të ndërmerren nga **Komisioni Qeverisës i Kodeve Teknike/Operacionale** i themeluar në pajtim me **Procedurën e menaxhimit të kodeve teknike/operacionale** të miratuar nga **Zyra e Rregullatorit për Energji**. **KOSTT** do të merr përgjegjësinë për inkorporimin e amendamenteve të cilat janë pajtuar nga **KQKO** dhe të miratuara nga **Zyra e Rregullatorit për Energji** dhe sipas nevojës do të nxjerrë versionet e amendamentuara të kodit.

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 18 nga 19</i>

## 8.2 Rrethanat e paparashikuara

### 8.2.1 Ndërmarrja e veprimeve

8.2.1.1 Nëse paraqiten rrethana të tilla të cilat nuk kanë mundur të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, **KOSTT** duhet të konsultohet menjëherë aq sa të jetë praktikisht e mundur në ato rrethana me të gjitha **palët** e dëmtuara dhe **Komisionin Qeverisës të Kodeve Teknike/Operacionale (KQKO)** në përpjekje për të arritur marrëveshje për veprimet që duhet ndërmarrë, nëse duhet. Nëse në kohën në dispozicion nuk mund të arrihet marrëveshje ndërmjet **KOSTT** dhe atyre palëve, **KOSTT** duke vepruar si operator i arsyeshëm dhe i kujdesshëm duhet të përcaktoj cilat veprime duhet ndërmarrë, nëse duhet. **KOSTT** duhet që sa më parë të jetë praktikisht e mundur t'i njoftoj **palët** dhe **Zyrën e Rregullatorit për Energji** për vendimin dhe arsyeshmëritë e tij.

8.2.1.2 Kurdoherë që **KOSTT** merr një vendim, duhet ta bëjë duke marr parasysh, kurdoherë që është e mundur në çdo rast të arsyeshëm, pikëpamjet e shfaqura nga **palët** tjera.

8.2.1.3 Pas ndonjë ngjarje, **KOSTT** menjëherë duhet t'i referoj të gjitha rrethanat apo vendimet të tilla **Komisionit Qeverisës të Kodeve Teknike/Operacionale** për konsiderim në pajtim me paragrafin 8.1.1.1.

### 8.2.2 Palët e prekura në pamundësi për të qenë në pajtueshmëri me këtë kod

8.2.2.1 Kur një **palë** nuk është në gjendje të pajtohet me obligimet e veta sipas këtij kodi për arsye të një **force madhore**, **pala** mund të njoftoj të gjitha **palët** e përfshira dhe **Zyrën e Rregullatorit për Energji** duke dhënë arsye në detaje për mos aftësinë e përmbushjes së obligimeve të tij, përse beson se këto arsye janë ngjarje e një **force madhore** dhe për kohëzgjatjen sa do të zgjasë **forca madhore**.

8.2.2.2 Gjatë kohëzgjatjes së **forcës madhore**, detyrimet e **palëve** do të pezullohen.

8.2.2.3 Nëse ndonjë **palë** mendon se deklarimi për **forcën madhore** është e paarsyeshme, ai mundet që çështjen t'ia referoj për shqyrtim **Zyrës së Rregullatorit për Energji** dhe vendimi i **ZRrE**-së do të jetë përfundimtar. Në rast se **ZRrE** përcakton se arsyet për mos pajtueshmëri nuk kanë qenë si pasojë e **forcës madhore**, atëherë obligimet e palës pretenduese nuk do të konsiderohen si të pezulluara.

	<b>KODI I PUNËS</b>	<b>PO-KO-011</b>
	<i>ver. 1.2</i>	<i>faqe 19 nga 19</i>

(Fundi i dokumentit)